

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja: Tonka Berishaj, kryetare, Have Haliti dhe Fillim Skoro, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Syzana Goxhuli, si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve: U.Gj. nga fsh. ... Komuna Gjakovë dhe R.Zh. nga ... R. e Serbisë, për shkak të veprës penale të kryer në bashkëkryeje Blerje, posedimi shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i akuzuari U.Gj. edhe për veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, i akuzuari M.B. nga Gjakova për shkak të veprës penale ndihmë në blerje posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, të akuzuarit D.M. dhe J.V. nga ..., për shkak të veprës penale ndihmë në blerje, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 dhe 33 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesat, mbrojtësit të akuzuarit U.Gj. av. T.B., të mbrojtësit të akuzuarit R.Zh. av. Q.J., të cilin në seancën e kolegjit e ka zëvendësuar av. H.M., mbrojtësi i të akuzuarit D.M. av. Zh.J. dhe mbrojtësi të akuzuarit J.V. av. P.K., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-DKR PKR.nr.95/17, të datës 29.12.2017, në seancën e mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, me datën 20.03.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të akuzuarit D.M., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-DKR, PKR.nr.95/17, i datës 29.12.2017, sa i përket vendimit mbi dënimin me gjobë dhe dënimin plotësues, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarit D.M., për veprën penale penale ndihmë në blerje, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 dhe 33 të KPRK-së, dënimin e shqiptuar me burg në kohëzgjatje prej 1(një) viti ia merr si të vërtetuar, kurse i shqipton dënim me gjobë në shumë në prej 500(pesëqind) euro, në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 euro të dënimin me gjobë, i akuzuari do të vuaj 1 (një) ditë burgim, kurse i kthehet vetura e konfiskuar markës "Citroen C3" me targa të regjistrimit BG-1058WS.

II. Refuzohen si të pa bazuara ankesat e mbrojtësve të akuzuarve U.Gj. dhe R.Zh., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-DKR, PKR.nr.95/17, i datës 29.12.2017, vërtetohet.

III. Hudhet si e pa afatshme, ankesa e mbrojtësit të akuzuarit J.V., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Gjakovë-DKR PKR.nr. 95/17, të datës 29.12.2017.

IV. Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i pa ndryshuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë-DKR, me aktgjykimin PKR.nr.95/17, të datës 29.12.2017, të akuzuarit: U.Gj. dhe R.Zh. i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Blerja, posedimi shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve substancave psikotropike dhe analoge të kryer në bashkëkryerje nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuarin U.Gj. edhe për veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, të akuzuarin M.B., për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale Blerja, posedimi shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, kurse të akuzuarit D.M. dhe J.V., i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale Blerja, posedimi shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve substancave psikotropike dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 31 dhe nenin 33 të KPRK-së, dhe i ka gjykuar: të akuzuarin U.Gj. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3(tre) vite, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt. 12.03.2017, e tutje , dënim me gjobë në shumën prej 5.000(pesë mijë)€, kurse për veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, dënim me gjobë në shumë prej 2000 (dymijë) €, cila gjobë duhet të paguhet në tre këste të barabarta, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk paguhet brenda afatit të caktuar të njëjtit i zëvendësohet dënimi me burgim, ashtu që për 20 euro do të vuaj 1 ditë burgu. Të akuzuarin R.Zh. dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.12.03.2017, e tutje, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 2000(dy mijë)€, i cili dënim do të paguaj në dy këste të barabarta pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 100 ditëve, ashtu që për çdo 20 € do të vuaj një ditë burgu. Të akuzuarin M.B. dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga dt.12.03.2017, deri më 07.11.2017, dhe nga dt.08.11.2017 deri më 29.12.2017, në masën e arrestit shtëpiak, si dhe i është shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind)€, i cili dënim duhet të paguhet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën, të njëjtit i zëvendësohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 25 ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg do të llogaritet nga 20€. Të akuzuarin D.M., dënimi me

burgim në kohëzgjatje prej 1 viti në të cilin dënimi i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt. 12.03.2017 e tutje, si dhe dënimi me gjobë në shumën prej 2.000 (dy mijë) €, i cili dënimi duhet të paguhet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata i zëvendëson dënimin me gjobë në dënim me burgim në kohëzgjatje prej 100 ditëve, ashtu që për çdo 20 € do të vuaj një ditë burg. Të akuzuarin J.V. dënim me burgim në kohëzgjatje pre 1(një) viti, në të cilin dënimi i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim, nga data 12.03.2017 e tuje, si dhe dënimi me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) €, i cili dënimi duhet të paguhet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën gjykata do ta zëvendësoj me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 25 ditëve, ashtu që për çdo 20€ do të vuaj 1 ditë burg.

Të akuzuarit U.Gj. i ka shqiptuar dënim plotësues, i është konfiskuar automjeti i udhëtarëve i markës “Pikap” me ngjyrë të kaltër, me targa regjistrimi 07-793-CG, si dhe substanca narkotike me peshë të përgjithshme prej 75.89.95 gr, si dhe i është konfiskuar telefoni i markës “Nokia” me kartelë xxx, i janë konfiskuar armët dhe atë pistololeta e tipit “Waltere” e kalibrit 7.65x17 një pushkë e gjahut llojit “Hugulu” 104A e kalibrit 12cm me nr. serik 01S3097 dhe pushka ajrore e llojit “KRAI 355” kalibrit 5.5 mm, një karikator AK-47, 15 fishekë të kalibrit 7.26mm, dhe 10 fishekë të kalibrit 12mm. Automjeti konfiskuar pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit do ti dorëzohet Agjensionit për administrimin e pasurisë së sekuestruar të cilët përmes ankandit do të shitet, mjetet e fituara do të derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës, ndërsa substanca narkotike dhe armët- municioni, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit do të asgjësohen.

Ndërsa të akuzuarit U.Gj. i janë kthyer automjeti i markës “Dogde Dakot” me targa tegjistrimi 07-493-AU, me ngjyrë të gjelbërtë të mbyllur, automjeti i markës “Dogde Ram”, me targa regjistrimi 07-867-BA me ngjyrë të hirit metalike dhe automjeti “Dacia” me targa regjistrimi 04-109-DG ngjyrë të kuqe i kthehen të akuzuarit, si dhe 9 orë të dorës të tipit Citizen, Watcheron, Konstant, Koss, Magnor, Lucerni Ck, Igeson, Tisson dhe Mecara, mjetet të cilat janë sekuestruar në shtëpinë e të akuzuarit e të cilat do ti kthehen pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, të cilat përkohësisht janë nën administrimin të Agjensionit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar.

Të akuzuarit M.B. i kthehen të hollat në shumën prej 554,84€ dhe telefoni i markës Iphone 6 me ngjyrë hiri.

Të akuzuarit R.Zh., i është shqiptuar dënim plotësues i janë konfiskuar të holla në shumë prej 3.950 (tre mije e nëntëqind e pesëdhjetë)€, të cilat janë fituar me veprën penale, i është konfiskuar telefoni Samsung me ngjyrë të bardhë, me kartelë xxx, dhe kartela e Serbisë me numër telefoni xxx, ndërsa i janë kthyer të hollat në shume prej 200 dinarë të Serbisë.

Të akuzuarit D.M., i është shqiptuar dënimi plotësues, i është konfiskuar automjeti i udhëtarëve i tipi ‘Citroen C3’ me targa të regjistrimit BG-1058WS. Ndërsa i është kthyer telefoni mobil model LG me kartelë xxx, si dhe i janë kthyer 2.530 dinarë të Serbisë.

Të akuzuarit U.Gj., Marsell Buzhala, R.Zh., D.M. dhe J.V., janë obliguar të paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sa do të kanë qenë sipas llogarisë së gjykatës së shkallës së parë, dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 100 (një qind) €, secili veç e veç, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesa kanë paraqitur:

Mbrojtësi i të akuzuati U.Gj., av.T.B., për shkak të vendimit mbi dënimin dhe shpenzimeve të procedurës penale, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ulët ose çështja të kthehet në rigjykim.

Mbrojtësi i të akuzuarit R.Zh., av. Q.J. për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, i akuzuari të lirohet nga përgjegjësia penale dhe ndaj tij të ndërpritet menjëherë masa e paraburgimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit D.M., av. Zh.J., për shkak të shkeljeve esenciale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Mbrojtësi i të akuzuarit J.V., av. P.K., për shkak të shkeljeve esenciale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, i akuzuari të lirohet nga aktakuza ose çështja të kthehet në rigjykim.

Prokuroria e Apelit me parashtresën PPA/I. nr.101/18 të datës 07.03.2018, ka propozuar që të refuzohen si të pa bazuara, ankesat e mbrojtësve të akuzuarve: U.Gj. av. T.B., R.Zh., av. Q.J., J.V., av. P.K., dhe Dushk Millovanoviq av. Zh.J., ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 par. 1 dhe 4 të KPPK-së, ka mbajtur seancën e kolegjit, prezent kanë qenë të akuzuarit U.Gj., R.Zh., J.V., dhe mbrojtësit e tyre av. Nik Shala, av. Zh.J., av. H.M. I cakzuar sipas detyrës zyrtare me pëlqimin e të akuzuarit R.Zh., se av. Q.J. e ka njoftuar gjykatën me shkrim se nuk është mire me shëndet dhe nuk mund të marrë pjesë në séance, si dhe përkthyesi i gjykatës Elez Baxhaku kurse nuk kanë prezentuar Prokurori i Apelit, i akuzuari D.M., për të cilin mbrojtësi i tij, av. Zh.J. njofton gjykatën se i njejtë ka marrë ftesë por ka pasur pengesa dhe nuk ka mundur që të marrë pjesë në seancë.

Gjykata e Apelit, ka shqyrtuar shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, të mbrojtësve të akuzuarve, aktgjykimin e ankimuar, pas vlerësimit edhe të shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Se ankesat e mbrojtësve të akuzuarve U.Gj. dhe R.Zh., janë të pa bazuara, kurse ankesa e mbrojtësit të akuzuarit D.M., pjesërisht është e bazuar.

Ndërsa ankesa e mbrojtësit të akuzuarit J.V., konform nenit 399 të KPPK-së, hudhet si e paafatshme, se i akuzuari aktgjykimin e ka pranuar me dt. 08.02.2018, ndërsa ankesën e ka bërë me dt.01.03.2018, që do të thotë jashtë afatit ligjor të paraparë për paraqitjen e ankesës.

Mbrojtësi i të akuzuarit D.M. në ankesë, pretendon se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata e shkallës parë nuk ka vërtetuar saktësinë e provave kundërthënëse, dispozitivi i aktgjykimit nuk përmban përshkrimin e veprimeve konkrete të mbrojturit tij, të cilat përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën është akuzuar, se nuk është vërtetuar se i akuzuari D. ka poseduar substancë narkotike, se substanca narkotike nuk është konfiskuar nga i akuzuari, e as që ka pasur kontakt me personin që e ka poseduar drogën, se qëllimi i ardhjes në Kosovë ka qenë që R.Zh.i të blej veturën, e ai është arrestuar në pikën kufitare në Jarinjë, kurse thasët me marihuan janë gjetur të një kontinjer 200 km larg kufirit, ska pasur asnjë marrëveshje për transportim, ka qenë i mashtruar dhe vetura e tij nuk është përdorur për bartjen e drogës, por për bartjen e udhëtarëve, aktgjykimi është bazuar në prova të pa pranueshme, nuk përmban arsye të mjaftueshme mbi faktet vendimtare, ndërsa arsyet që janë dhënë, janë të paqarta. Këto të meta paraqesin shkelje të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika 1.8 dhe pika 1.12 lidhur me nenin 370 pika 4.6.7 dhe 8 të KPK-së, të cilat aktgjykimin e bëjnë të pa qëndrueshëm.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit, pretendimet ankimore të mbrojtësi të akuzuarit D.M., se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, nuk qëndrojnë, e as që ka shkelje tjera esenciale të cilat kjo gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare, edhe sa ju përket të akuzuarve tjerë, që kishte me ndikuar në anulimin e aktgjykimit. Aktgjykimi i ankimuar është përpiluar në harmoni me dispozitat e nenit 370 par.7, të KPPK-së, ku janë shënuar faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, për të cilën i akuzuarit është shpallur fajtor si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse. Se në aktgjykimin e ankimuar nuk ka kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit, kjo për arsye se gjykata e shkallës se parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, ka dhënë arsyet e mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare, që kanë të bëjnë me përgjegjësin penale të akuzuarit D.M., e që vërtetohet nga gjetja e një letre në xhepin e të akuzuarit ku ka qenë e shënuar emëri i të akuzuarit U.Gj. dhe numri i telefonit dhe adresa, se edhe nga raporti i vëzhgimit me masa të fshehta dhe nga përgjimet telefonike është konstatuar se ditën kritike i akuzuari U.Gj. është takuar me R.Zh.in, e që ka qenë më veturën e tipit “Citroen” me targa BG-1058WS pronë e të akuzuarit D.M., së bashku me J.V.in.

Mbrojtësi e të akuzuarit D.M., në ankesë pretendon, se me aktgjykimin e ankimuar gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë, se gjykata e shkallës se parë, me asnjë provë nuk e ka vërtetuar se i mbrojturi i tij ka ndërmarrë veprime lidhur me veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, se gjykata e shkallës se parë është bazur vetëm në një letër ku ka qenë e shënuar emri i të akuzuarit U.Gj. nr. i telefonit dhe adresa, sepse as shkrimi në atë letër nuk i takon të mbrojturit të tij, i

mbrojturi i tij nuk ka pasur asnjë kontakt me pronarin e drogës, vetëm se ka ardhur me veturë me R.Zh. për blerjen e veturës, dhe vetura nuk është përdorur për qëllime tjera.

Mbrojtësi i të akuzuarit R.Zh. av. Q.J., ka pretenduar se gjykata e shkallës se parë nuk e ka vërtetuar në asnjë provë faktin se i akuzuari R. ka qenë i involvuar në kryerjen e veprës penale. Se sasia substancës narkotike është gjetur afër disa kontinjerëve, në afërsi të restorantit “NN” për të cilët narkotikë është pretenduar se është planifikuar për transport, se i mbrojturi i tij ka ardhur në Kosovë për blerjen e veturës, se shumica e parave prej 4000 (katë mijë) € e gjetur të i akuzuari natën kritike ka qenë për blerjen e veturës, e jo për transportimin e substancës narkotike, se nga transkriptet e bisedave telefonike, nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij ka biseduar për transportimin e substancës narkotike, por ato biseda kanë qenë shoqërore dhe nuk kishin të bëjnë me substanca narkotike.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit, pretendimet ankimore nga ana e mbrojtësve të akuzuarve D.M. dhe R.Zh. përkritazi me bazën ankimore vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjedjës faktike, nuk qendrojnë, se nga shkresat e lëndës, procesverbalet e shqyrtimit gjyqësor, si dhe provave materiale, del se me datën 11.03.2017 rreth orës 20:00, i akuzuari R.Zh., kishte ardhur në Kosovë, se bashku me të akuzuarit J.V. dhe D.M., pronar i veturës “Citroen” me targa BG -1058WS me të cilin kishin udhëtuar, i akuzuari R. kishte kontaktuar vazhdimisht për mes telefonit me të akuzuarin U.Gj.n, për të caktuar vendin se ku do të takohen për të transportuar sasinë e substancës narkotike në peshë prej 32 kg të cilën i akuzuari U.Gj. e kishte sjellur deri të restorantit “NN” sipas bisedës telefonike me R.in, e kishte hudhur në afërsi të dy kontinjerave, me qëllim që ta marrin me veturën e tipit “Citroen” me targa BG -1058WS, të cilën e kishte drejtuar i akuzuari D.M., por e kanë vërejtur se janë duke u përcjellur nga policia dhe janë larguar, për këtë transport i akuzuari U.Gj. ja kishte dhenë të akuzuarit R.Zh. 4000€, të i cili janë gjetur me rastin e arrestimit dhe janë sekuestruar.

Se nuk është kontestuese se i akuzuari D.M., ditën kritike ka qenë në shoqëri së bashku me R.Zh.in dhe J.V. deri sa ai ka biseduar me U.Gj.n, rreth dorëzimit të substancës narkotike, se nga biseda telefonike të cila janë marrë sipas urdhresës së gjykatës, R.i i thotë U. se janë duke u përcjellur policia dhe e udhëzon se ku me lënë substanën narkotike, të cilën U. e gjuan në 4 thasë pranë një kontinjeri të bërlllogut, kurse i akuzuarit R.Zh. ka qenë tërë kohën në shoqëri me të akuzuarit Jugosllav dhe D. me veturën e tij, e që vërtetohet nga raporti i i vëzhgimit për të cilin është lëshuar urdhëresa për masa të fshehta, ku në vëzhgim dhe monitorim ka qenë i akuzuari U.Gj., ku janë përcjellë lëvizjet e tij dhe personat me të cilët ka kontaktuar, se i njejtë ka kontaktura me personat që kanë lëvizur me veturën e D.M., pronar i veturës “Citroen” me targa BG -1058WS, në të cilën veturë kanë qenë katër persona, prej të cilëve tre janë identifikuar se kanë qenë R.Zh.in dhe J.V., kurse personi i katërt ka mbetur i pa njohur.

Nuk është kontestuese se i akuzuari D.M., i ka sjellur të akuzuarit R.Zh.in dhe J.V., me veturën e tij deri në Kosovë, dhe ka pasur njohuri se po bisedohet për transportimin e substancës narkotike, se gjatë tërë kohës i akuzuari R. ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me të akuzuarin U.Gj. ai ka qenë në shoqëri më te, kurse nuk qëndron pretendimi i mbrojtjes, se i akuzuari D. se nuk ka qenë në njohur, se i akuzuari

R. ka ardhur për të transportuar substancë narkotike, por ka ardhur për të shoqëruar për blerjen e veturës.

Se gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur në mënyrë të plotë dhe të qartë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i ka konsideruar të vërtetuara, në mënyrë të veçantë ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse dhe ka paraqitur arsyet se pse konsideron se në veprimet e të akuzuarve R. dhe D. ekzistojnë elementet e veprës penale për të cilat i ka shpallur fajtor. Se i akuzuari U.Gj. gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka pranuar fajësinë, i cili ditën kritike ka qenë nën masat e vëzhgimit, sipas urdhëresës së gjykatës, e nga masat e vëzhgimit është vërtetuar se i akuzuari R.Zh.in gjatë gjithë kohës ka pasur biseda telefonike dhe ka kontaktuar me të akuzuarin U. duke lëvizur me veturë nga qyteti i Gjakovës në Klinë dhe Graçanicë, se i ka marrë 4000 € në emër të transportit të substanës narkotike, e të cilat janë gjetur në xhepin e tij, ai në shqyrtimin gjyqësor është mbrojtur në heshtje, kurse nuk qendrojnë pretendimet e mbrojtjes të akuzuarit D. se nuk ka qenë në njohuri se çka ka biseduar i akuzuari R. me të akuzuarin U.Gj., sepse gjatë gjithë kohës kanë qenë sëbashku, në xhep i është gjetur adresa dhe numri i telefonik U.Gj., se nuk është me rëndësi se nga kush është shkruar, por është provë se ai ka pasur njohuri se kush është U.Gj., si dhe qëllimin e kontaktit të tyre me te. Prandaj Gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vepruar kur nuk ua ka falur besimin mbrojtjes se të akuzuarve, të cilët kanë deklaruar se në Kosovë kanë ardhur për të blerë veturë i akuzuari R. dhe për të vizituar manastirin. Nga arsyet që u dhanë më lartë, kjo gjykatë gjen se janë të pabazuara pretendimet e mbrojtësve të akuzuarve, se më aktgjykimin e ankimuar gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë jo të plotë dhe të gabuar, gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, e aprovon edhe kjo gjykatë

Sipas vlerësimit të gjykatës se Apelit, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar ligjin penal, në dëm të akuzuarit D.M. kur i ka shqiptuar dënim plotësues, duke i konfiskuar automjeti i udhëtarëve i tipi 'Citroen C3' me targa të regjistrimit BG-1058WS, se automjeti në fjalë është konfiskuar në kufirin Jarinjës derisa i akuzuari ka qenë duke kaluar pikën kufitare dhe në automjet nuk është gjetur substanca narkotike, gjykat e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të konfiskimit, se substanca narkotike nuk është gjetur në veturë.

Mbrojtësi i të akuzuarit U.Gj., sa i përket vendimit mbi dënimin pretendon, se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është tejet i ashpër, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, ka shpreh pendim për veprën e kryera penale, si dhe për shpenzimet të procedurës penale pa cekur në ankesë se cilat janë ato.

Mbrojtësi i të akuzuarit R.Zh., në ankesë pretendon se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, është i pa bazë, se i mbrojturi i tij nuk është involvuar në kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë.

Mbrojtësit e të akuzuarit D.M., pretendonë se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është i pa bazë, për faktin se veturën të cilën e ka poseduar i akuzuari nuk është përdorur për kryerjen e veprës penale, ka propozuar që i akuzuari të lirohet nga akuza dhe të lirohet edhe nga shqiptimin i dënimit plotësues, marrja e veturës.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit ka pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, sipas dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së kështu që për të akuzuarin U.Gj. si rrethanë lehtësuese i ka marrë për bazë pranimin e fajësisë, është penduar për veprën e kryer penale, është i martuar dhe babë i dy fëmijëve të mitur, sjelljet e mira gjatë shqyrtimit gjyqësor, më parë nuk ka qenë i dënuar, për të akuzuarin R.Zh., se është i martuar babë i tre fëmijëve, për të akuzuarin D.M. se është i martuar babë i dy fëmijëve, kurse si rrethanë rënduese, ka marrë për bazë peshën e veprës penale, pasojat e veprës penale për shendetin e të rinjëve.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit, pretendimet e përmendura ankimore nga ana e mbrojtësve të akuzuarve U.Gj. dhe R.Zh., nuk qëndrojnë, nga se gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat siç parashihen me dispozitat e nenit 73 të KPK-së. Rrethanat lehtësuese që i ka marrë parasysh gjykata e shkallës së parë për të akuzuarit me rastin e caktimit të dënimit, pranimin e fajësisë për të akuzuarin U.Gj., pendimin për veprën e kryer, është babë i dy fëmijëve sjelljet e mira, më parë nuk ka qenë i gjykuar, për të akuzuarit R.Zh., se është i martuar babë i tre fëmijëve, i aprovon edhe kjo gjykatë sa i përket dënimit të shqiptuar me burgim. Mbrojtësit e të akuzuarve nuk theksojnë asnjë rrethanë konkrete lehtësuese e cila kishte me ndikuar që dënimi të jetë më i butë nga ai i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, prandaj pretendimet e mbrojtësve të akuzuarve se dënimi i shqiptuar është i ashpër, janë të pa bazuara.

Ndërsa, sa i për ketë pretendimeve ankimore të mbrojtësit akuzuarit D.M. rrethanat lehtësuese që i ka pasur parasysh gjykata e shkallës së parë me rastin e përcaktimit të dënimit me burgim, se është i martuar, babë i dy fëmijëve, i aprovon edhe kjo gjykatë, por duke pasur parasysh edhe faktin, se roli i të akuzuarit D.M. në raport me të akuzuarit R.Zh. ka qenë më i vogël, kjo gjykatë gjen se dënimi i shqiptuar me gjobë të akuzuarit D.M. është i ashpër, si dhe nuk ka bazë për konfiskimin e veturës i tipi “Citroen C3” me targa të regjistrimit BG-1058WS, prandaj edhe e ndryshoj vendimin mbi dënim me gjobë, në vend të dënimit me gjobë në shumë prej 2000(dymijë) €, të njejtit i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 500(pesëqind) €, si dhe i kthehet vetura konfiskuar, me bindje se ky dënim është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, dhe se me këtë dënime do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Sipas kësaj Gjykate, dënimi që iu është shqiptuar të akuzuarve U.Gj. dhe R.Zh. nga gjykata e shkallës së parë, janë në harmoni me intenzitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve, rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, se ky dënim duhet të jetë në shërbim të preventivës së përgjithshme, forcimit të moralit të shoqërisë, përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe është në pajtueshmëri me kërkesat për sigurinë personale dhe pasurore të shoqërisë, se dënimi i shqiptuar është në funksion të parandalimit të kryrësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre dhe të ndikoj edhe në personat tjerë që mos të kryejnë vepra penale, me të cilin dënimin ndaj të akuzuarve do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPK.

Prandaj, nga arsyet e sipër cekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 401 dhe 399 të KPPk-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.102/2018 me 20.03.2018

Procesmbajtësja,
Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit,
Have Halitit, _____
Fillim Skoro, _____

Kryetari i kolegjit,
Tonka Berishaj